



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:175609

Datë: 22.08.2024

Numri i dokumentit: 06076892

P.nr.154/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICE, DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.R., nga fshati ... komuna e Vushtrrisë, për shkak te veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nenpar 1.4 te KPRK-së, dhe te pandehurit B.A. te cilin sipas autorizimit e mbron av. Valdet Kadriu, për shkak te veprës penale Lëndim i rende trupor nga neni 186 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 te KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit i Përgjithshëm PP-II-nr.1051/2024 të datës 02.07.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të datës 22.07.2024 po te njëjtën dite mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 22.08.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të akuzuarit:

B.R. nga i ati E... dhe nëna F..., e vajzërisë A..., i lindur më ..., në Vushtrri, me vendbanim në fshatin ... Komuna Vushtrri, beqar, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, dhe

B.A. nga i ati J... dhe nëna F..., e vajzërisë N..., i lindur më ..., në Vushtrri, me vendbanim në rrugën "...", nr. ..., Vushtrri, i martuar prind i katër fëmijëve, i vet punësuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

JANË FAJTORË

SEPSE:

I. B.R., me datë 20.06.2024, rreth orës 12:30, në Vushtrri, në rrugën "...", saktësisht në lokalitë "...", i pandehuri me dashje i shkakton lëndim trupor personit tjetër – B.A. në atë mënyrë që, derisa B.A. kishte qenë në lokal duke punuar, aty kishte shkuar i pandehuri B... bashkë me dëshmitarin A.S. ku iu kishte drejtuar me fjalë "A është ky emër i rendë" e më pas e kishte goditur me grusht në fytyrë duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore të konstatuara edhe nga akt ekspertiza mjekoligjore si plagë shqyese në buzën e sipërme të gojës, ndrydhje të indeve të buta

të gingives së gojës dhe regjionit të dhëmbëve prerës, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë që si të tilla bëjnë pjese në dëmtime të lehta trupore me pasojë të përkohshëm për shëndetin.

Me këto veprime ka kryer veprën penale **Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par 1 1.4 të KPRK-së.** (Kodi nr. 06/L-074).

II. B.A., me datë, kohë dhe vend si në pikën e parë të dispozitivit të kësaj aktakuze, i pandehuri B... me dashje i shkaktonte lëndime të rënda trupore personit tjetër – B.R., në atë mënyrë që, derisa kishte qenë në lokal të tij, aty shkon i pandehuri B... duke i thënë “A është ky emër i rendë” e më pas e godet në fytyrë, ku ndërhyjnë dëshmitari A.S. për t’i ndarë dhe derisa dëshmitari ishte duke i folur B.R., i pandehuri B.A. shkon nga prapa dhe me **një mjet të përshtatshëm e godet** në dorë të majtë duke i shkaktuar lëndim të rënda trupore të konstatuara nga akt ekspertimi mjekoligjor dhe atë plagë shqyese në bërrylin e majtë, thyerje të hapur në bërryl (thyerje e ulnes) të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë që **si të tilla bëjnë pjese në dëmtime të rënda trupore.**

Me këto veprime ka kryer veprën penale **Lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par. 3 nenpar. 3.1 e lidhur me par. 1 të KPRK-së** (Kodi nr. 06/L-074).

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 47, 48 si dhe nenin 186 par.3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 të KPRK-se si dhe neni 364, 452 dhe neni 462 të KPPK-së Gjykata i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me të cilin të akuzuarit B.R. i vërteton dënimin me burgim prej 3 tre muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në periudhën verifikuese prej një viti, nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale.

Të pandehurit të dytë B.A. gjykata i vërteton dënimin me burgim prej gjashtë 6 muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në periudhën verifikuese prej një viti.

Koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt. nga data 20.06.2024 e deri me datë 22.07.2024, i wshtw llogaritur në dënimin shqiptuar.

OBLIGOHEN të akuzuarit që secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga 30€, në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumen prej nga 20€, në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumen prej nga 10€ si dhe i pandehuri B.A. edhe shumën prej 60€, në emër të transportit.

Të pandehurit, në cilësinë e palës së dëmtuar kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP-II-nr.1051/2024 të datës 02.07.2024, kundër të pandehurit B.R., nga fshati ... komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nenpar 1.4 të KPRK-së, dhe të pandehurit B.A., për shkak të veprës penale Lëndim i rende trupor nga neni 186 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 22.07.2024 ku në këtë seancë të shqyrtimit fillestar gjyqtari i vetëm gjykues i ka njoftuar të pandehurit me të drejtat e tyre në këtë çështje penale. Te pandehurve iu është lexuar aktakuza PP-II-nr.1051/2024 të datës 02.07.2024 nga ana e prokurorit të shtetit dhe të njëjtit janë deklaruar se e kuptojnë në tërësi aktakuzën. Në kuptim të dispozitave të nenit 241 të KPP-së, pasi që gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, të akuzuarve iu është dhënë mundësia të pranojnë ose të mos e pranojnë fajësinë sipas aktakuzës.

Lidhur me pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, i pandehuri i parë B.R. ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dhe ka shtuar se ka qenë një moment që ka dalë prej vetës dhe është ndje shumë keq, e edhe sot ndihet keq pasi ka qenë diçka e pahijshme për ne duke aluduar ne të dy të pandehurit, njihemi që sa kohë dhe me të vërtetë ndihem shumë keq. I kemi kërkuar falje njëri tjetrit dhe jemi pajtuar si familje, ja kemi lyp hallallin dhe jemi në rregull tani. Në cilësi të dëmtuarit nuk ka kërkuar kompensim dëmi nga i pandehuri B.A..

I pandehuri dytë B.A. pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij ka deklaruar se don ta pranojë fajësinë sipas aktakuzës dhe ka shtuar se nuk ka prit se do të ndodhë diçka e tillë, ishalla nuk ndodh më kurrë, ka theksuar se kurrë më përpara nuk kanë pasur probleme dhe me të pandehurin njihen edhe më parë dhe nuk kanë pasur probleme asnjëherë, ka qenë e rastit gjithë ajo që ka ndodhur, ka ndodhur aty për aty dhe janë penduar për gjithë atë që ka ndodh. I ka kërkuar falje të pandehurit tjetër dhe e ka pranuar kërkim faljen nga i pandehuri i parë B.R., duke shtuar se edhe familjet e tyre janë takuar dhe gjithçka është në rregull mes tyre, në të ardhmen nuk pritet që të kenë ndonjë problem, pasi që tani i kanë raportet edhe më të mira se që i kanë pasur.

Pas pranimit të fajësisë, gjykata ia ka tërhequr vërejtjen të pandehurit lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë dhe të njëjtin e ka njoftuar për dënimet e parapara, se nuk do të mund të kundërshtojë provat apo të parashtroj prova në këtë çështje penale, se nuk mund ta atakojë vendimin e gjykatës për shkak të vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, por mund ta atakojë për shkak të lartësisë së dënimit dhe se deklarimi mbi pranimin e fajësisë, gjykata detyrimisht do ta vlerësojë si rrethanë lehtësuese, gjykata paraprakisht e ka njoftuar të pandehurin rreth benefiteve lidhur me pranimin e fajësisë.

I pandehuri i parë B.R. në shqyrtimin fillestar edhe pas tërheqjes së vërejtjes lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë, i njëjti ka deklaruar se e ndien vetën fajtor.

I pandehuri i dytë B.A. në shqyrtimin fillestar edhe pas tërheqjes së vërejtjes lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë, i njëjti ka deklaruar se e ndien vetën fajtor.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se deklarimi mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është në përputhje dispozitat e KPPRK-së për institutin e pranimit të fajësisë, i njëjti mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, është bërë në mënyrë vullnetare dhe të pandehurit e kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë, i propozojmë gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovojë. Andaj, nëse gjykata e aprovon pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit propozon që të pandehurit t'i shpallë fajtorë dhe t'i dënojë sipas ligjit, ndërsa gjatë matjes së dënimit, përcaktimit të llojit dhe lartësisë së tij të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ashtu që si rrethana lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, ndërsa si rrethana rënduese gjykata të merr parasysh shkallen e lartë të dashjes në drejtim të kryerjes së veprës penale për të dy të pandehurit, po ashtu prokurori i shtetit propozon gjykatës që sipas detyrës zyrtare të pajiset me certifikatë nga evidenca penale dhe nëse nga ajo rezulton se të pandehurit janë dënuar edhe më parë ta merr si rrethanë rënduese dhe e kundërta nëse nuk janë dënuar më parë, ta merr parasysh si rrethanë lehtësuese. Po ashtu me rastin e shpalljes fajtorë të të pandehurve, të njëjtit t'i obligojë të paguajnë shpenzimet e procedurës penale, shpenzimet për ekspertizë mjeko ligjore dhe të paguajnë taksën për kompensimin e viktimave të krimit, secilin veç e veç.

Mbrojtësi i te pandehurit te dytë ne fjalën e tij lidhur me pranimin e fajësisë se te pandehurit ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga i mbrojturi është bërë pas këshillimeve të mjaftueshme lidhur me materiale, provat dhe faktet që përmban kjo aktakuze, i njëjti është i informuar edhe për pasojat e pranimit të fajësisë, por megjithatë i njëjti ka vendosur që me vullnet dhe pa presion, në mënyrë të sinqerte ta pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë pranimin e fajësisë, ngase janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e fajësisë nga ana e të pandehurit B.A.. Po ashtu mbrojtësi gjykatës i ka propozuar që me rastin e përcaktimit të lartësisë dhe llojit të dënimit ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë se i akuzuari është baba, familjar, mbajtës i familjes dhe deri tani nuk është dënuar për ndonjë veprë penale dhe nuk ka raste tjera të hapura as në polici e as prokurori, ka bashkëpunuar me policinë, ashtu që pas incidentit e ka thirr policinë dhe e ka njoftuar lidhur me veprimin e tij, i njëjti ka shprehur keqardhjen e tij, jo vetëm gjatë seancës së sotme por edhe gjatë deklarimit të tij në polici, pas kryerjes së veprës penale i njëjti ka pasur sjellje korrekte në përgjithësi, ashtu që i njëjti ka iniciuar pajtimin me të akuzuarin tjetër apo të dëmtuarin duke aluduar ne te akuzuarin B.R., gjithashtu gjykata duhet ta ketë parasysh se i njëjti ka vepruar duke qenë fillimisht i provokuar nga grushtimi nga pala tjetër, dhe të gjitha këto arsye që i përmendim lusim gjykatën që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit konform dispozitave të nenin 71, nenin 72 të njëjtit ti shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj, apo lloj tjetër të dënimit, duke konsideruar se në përputhje me rrethanat familjare dhe personale që e karakterizojnë të akuzuarin, me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit dhe efekti i dënimit.

Gjykata pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve e ka vlerësuar në kuptim të dispozitave të nenit 242 par 1 të KPP-së dhe ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës si dhe ka pranuar deklarimin mbi pranimin e fajësisë nga të pandehurit sepse ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndes dhe atë, akt ekspertimi mjeko ligjor i dt. 24.06.2024; procesverbali i marrjes në pyetje të te pandehurit B.A. në prokurori dt. 26.06.2024; procesverbali i marrjes në pyetje në polici të te pandehurit B.R. dt. 23.06.2024; informacionet e personit për te pandehurin B.R.; raporti i qendrës emergjente në Vushtrri dt. 20.06.2024, në emër të te pandehurit B.R.; raporti i qendrës emergjente në Vushtrri dt. 20.06.2024, në emër të te pandehurit B.A.; Raportet mjekësore nga QKU Prishtinë në emër të te pandehurit B.R.; raporti shtesë i policit hetues dt. 23.06.2024; deklarata e dëshmitarit A.S. dhënë në polici me dt. 20.06.2024; deklarata e te pandehurit B.A. dhënë në polici dt. 20.06.2024; informacionet e personit për te pandehurin B.A.; raporti i oficerit dt. 20.06.2024; raporti i policit hetues dt. 20.06.2024, si dhe shkresat e tjera të lëndes.

Të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale, e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që e ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë gjykata ka vlerësuar këto prova dhe deklarimet mbi pranimin e fajësisë i ka vlerësuar dhe pranuar.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për te pandehurin e parë B.R., Gjykata në vështrim të dispozitave të nenit 69 e 70 të KPRK-së ka marrë parasysh por pa u kufizuar në rrethanat lehtësuese dhe renduese në vijim ku si rrethanë lehtësuese, për te pandehurin e parë gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, bashkëpunimin vullnetar të te pandehurit të parë në të gjitha fazat e kësaj procedure, keqardhjen e shfaqur, sjelljen e te pandehurit pas kryerjes së veprës penale ku i njëjti ka kërkuar falje nga i pandehuri i dytë dhe kërkim falja është pranuar. Sa i përket rrethanave renduese gjykata konsideroj, shkallen e lartë të dashjes së te pandehurit të parë, si dhe prezencën e dhunës.

Sa i përket te pandehurit të dytë B.A., në vështrim të dispozitave të nenit 69 e 70 të KPRK-së ka marrë parasysh por pa u kufizuar në rrethanat lehtësuese dhe renduese në vijim ku si rrethanë lehtësuese, për te pandehurin e dytë gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, dëshminë se i njëjti ka qenë i provokuar nga i pandehuri i parë, rrethanat personale të te pandehurit të dytë, bashkëpunimin vullnetar të te pandehurit të dytë në të gjitha fazat e kësaj procedure, keqardhjen e shfaqur, sjelljen e te pandehurit të dytë pas kryerjes së veprës penale ku i njëjti ka kërkuar falje nga i pandehuri i parë dhe kërkim falja është pranuar, dhe tani raportet e tyre janë të mira. Sa i përket rrethanave renduese gjykata konsideroj, prezencën e dhunës, por që rrethana tjera renduese nuk gjeti.

Në nenin 185, par.1, nenpar 1.4 të KPRK-së është parashikuar se formën themelore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, për te cilën edhe është akuzuar i pandehuri i parë, e kryen: “ Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në: 1.4. dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.”

Kurse sa i përket veprës penale me te cilën akuzohet i pandehuri i dytë dispozita e nenit 186, par.1, të KPRK-së është parashikuar se formën themelore të veprës penale Lëndim i rëndë trupor e kryen “Kushdo që i shkakton lëndim të rëndë trupor personit tjetër ose e dëmton shëndetin e personit tjetër deri në masën e tillë sa që mund të rezultojë me: 1.1. dobësimin e përkohshëm ose esencial të një pjese vitale të trupit të personit tjetër; 1.2. paaftësimin e përkohshëm, zvogëlimin e përkohshëm dhe esencial ose zvogëlimin e përhershëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar; ose 1.3. dëmtimin e përkohshëm dhe serioz të shëndetit të personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Kurse si formë e kualifikuar e kësaj vepre penale është dispozita e nenit 186 par 3 nenpar 3.1 ku qëndron se “Kur vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me: 3.1.burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni” e qe ne rastin konkret ne veprimet e te pandehurit te dytë është kryer pikërisht kjo formë e kualifikuar e veprës penale.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat (rënduese dhe lehtësuese) të cekura më lartë, për te pandehurin e dytë B.A., ka vlerësuar se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për aplikim të dispozitave për zbutjen e dënimit nga 71 i cili parasheh “Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit: 1.1. kur ligji parasheh që dënimi i kryesit mund të zbutet apo të zvogëlohet; 1.2. kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë; ose 1.3. në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë.” dhe 72 par.1, pika 1.5 në të cilin edhe parasheh “Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 i këtij Kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim: nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar me dënimi me kusht me te cilin te pandehurit te parë i është vërtetuar dënimi me burgim prej tre muaj i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne periudhën verifikuese prej një viti dhe për te pandehurin e dytë dënimi me kusht me te cilin te pandehurit te dytë i është vërtetuar dënimi me burgim prej gjashtë muaj i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne periudhën verifikuese prej një viti si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur te te pandehurve dhe se nuk ka pasur vend qe gjykata te shqiptoj dënim me te ashpër apo me te butë.

Gjykata vlerëson se dënimi me kusht ne rastin konkret është i domosdoshëm në mënyre qe ndaj te pandehurve te arrihet qëllimi i dënimit si ne dispozitat e nenit 38 te KPRK-së dhe atë qe të parandalojë kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale qe kanë kryer, dhe te ndikoj ne ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Së këndejmi me pranimin e gjitha këtyre rrethanave, nuk ka pasur vend që të pandehurve të iu shqiptohen dënime më të rënda apo më të bute.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Nga të lartë cekurat e bazuara në nenin 364 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.154/24, datë: 22.08.2024

Zyrtarja Ligjore
Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi. Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.